



Njoftim për tender

Data e publikimit: 18.03.2026

Emri i subjektit kontraktues: Tek Bunkeri

Adresa: Lagjja No.1, Rruga e Kavajes prane Bashkise, ndertese 1 kateshe, 2503

Rrogozhina, Tirana,

Email: info@tekbunkeri.eu

Afati për dorëzimin e ofertave: 18/03/2026 - 01/04/2026

Projekti “BRIDGES – Building Resilience, Inspiring Democratic Generations” synon të forcojë kulturën demokratike në Shqipëri duke adresuar të kaluarën autoritare përmes qasjeve inovative që ndërthurin gazetarinë, arkivat dhe artin. Duke u fokusuar te të rinjtë dhe komunitetet e prekura, projekti transformon dëshmitë dhe traumat e të mbijetuarve të persekutimit politik dhe shoqërisë shqiptare në përmbajtje të aksesueshme dhe angazhuese për publikun. Një nga komponentët kryesorë është krijimi i një albumi hip-hop që përkthen këto histori në gjuhë bashkëkohore për të rritur ndërgjegjësimin dhe empatinë. Përmes aktiviteteve si muzikë, teatër, podcast dhe media, projekti synon të luftojë nostalgjinë dhe dezinformimin mbi të kaluarën. Në këtë mënyrë, “BRIDGES” kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të informuar, kritike dhe aktive në proceset demokratike. Projekti zbatohet nga Tek Bunkeri si organizatë udhëheqëse, në partneritet me Albanian Center for Quality Journalism (ACQJ), Citizens Channel dhe Kujto.al. Në kuadër të këtij projekti organizata kërkon të realizojë 10 këngë të zhanerit hip hop, për realizimin e të cilave është i nevojshëm shërbimi i produksionit dhe post produksionit.

Kjo procedurë zhvillohet si procedurë konkurruese e negociuar, në përputhje me rregullat e prokurimit, ku do të pranohen minimalisht 3 oferta, në të kundërt procedura e tenderimit do të zgjatet. Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe specifikimet teknike deri më date 01/04/2026, në adresën e email-it: info@tekbunkeri.eu.

Specifikimet teknike:

Tek Bunkeri do të zhvillojë procedurën e prokurimit për shërbimin sipas cilësimeve në tabelën e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi i shërbimit	Çmimi/Njësi (Pa TVSH)	Çmimi/Njësi (Përfshirë TVSH)
----	------------------------	-----------------------	------------------------------



Tek Bunkeri

1.	Produksioni dhe post produksioni i 10 (dhjetë) këngëve hip hop		
----	--	--	--

Përshkrim i detajuar i specifikimeve teknike:

Subjekti realizon produksionin e 10 këngëve instrumentale bashkë me refrenin në rast se kënga ka refren, gjithashtu produksioni i intro-ve, refrenit dhe outro-ve. Subjekti koordinon instrumentistët e përfshirë për krijimin e muzikës dhe këngëtarët e hip hop-it.

Subjekti realizon miksimin dhe masterizimin e instrumenteve në cilësi të përshtatshme për printim në pllakë gramafoni dhe cilësi të përshtatshme për publikim në Spotify.

Subjekti mbikëqyr tekstet dhe linjën vokale të artistëve.

Produktet përfundimtare duhet të dorëzohen në formate profesionale audio (WAV24bit / 48kHz për master dhe MP3 320 kbps për publikim).

Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën 06/04/2026 - 01/08/2026 Në rast mosrespektimi të afateve apo cilësisë së kërkuar të shërbimit, Tek Bunkeri rezervon të drejtën të aplikojë penalitete ose të ndërpresë kontratën.

Kushtet e pëgjithshme:

- Subjektet duhet të jenë të licensuar në mënyrë të rregullt dhe ligjore me objekt veprimtarie shërbimet e lartpërmendura;
- Subjektet duhet të dërgojnë si link, këngë të mëparshme që kanë prodhuar
- Dorëzimi i ofertave duhet të kryhet nëpërmjet email-it në adresën: info@tekbugkeri.eu brenda datës 01/04/2026
- Pagesa e subjektit do të kryhet me transfertë bankare e ndarë në 3 këste, kësti i parë pas dorëzimit të 3 këngëve të para, kësti i dytë pas dorëzimit të 3 këngëve të tjera, dhe kësti i fundit pas dorëzimit përfundimtar të 4 këngëve të fundit.
- Tek Bunkeri rezervon të drejtën të refuzojë çdo ofertë që nuk përmbush kriteret teknike dhe administrative.
- Ofertuesit duhet të deklarojnë se nuk ndodhen në situatë konflikti interesi me Tek Bunkeri apo partnerët e projektit.

Vini re: Ofertat dorazi dhe të dorëzuara pas përfundimit të afatit, nuk pranohen dhe nuk do shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit të ofertave

Ofertuesit duhet të paraqesin të dhënat e plota të personit të kontaktit të subjektit.

Bashkëngjitur me ofertën financiare e cila duhet të jetë në monedhën LEKË sipas tabelës së mësipërme, me çmimin e qartë pa TVSH dhe me TVSH-në e përfshirë në çmim, ofertuesit



Tek Bunkeri

duhet të paraqesin këto dokumenta:

- Licensën për ushtrimin e aktivitetit / Ekstraktin nga QKB të marrë deri një ditë para publikimit të kërkesës për ofertë;
- Numrin e llogarisë bankare.

Operatori ekonomik do të përzgjidhet mbi bazën e përputhshmërisë me specifikimet teknike dhe ofertës më të ulët financiare ndër ofertat e pranueshme.
